



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 37, Datë 11.02.2021

MBI

MIRATIMIN E KËRKESËS SË FTL SH.A., PËR SHTYRJEN E HYRJES NË FUQI TË VENDIMIT NR. 202, DATË 02.12.2020, PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR PROCEDURAT E SHITJES SË TEPRICAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË TREGUN E PARREGULLUAR PËR SHOQËRINË PUBLIKE TË FURNIZIMIT”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 104, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 11, pikat 2 dhe 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 11.02.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 25/3 Prot., datë 08.02.2021, të Drejtorive Teknike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL sh.a.) me shkresën nr. 320/1 prot., datë 04.02.2021 kërkoi nga ana e ERE shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi të “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 202, datë 02.12.2020, deri në fund të muajit Prill 2021.
- Me vendimin e bordit të ERE, sipërcituar, u vendos miratimi i “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë, FTL sh.a.”, hyrja në fuqi e së cilës u vendos pas botimit në Fletoren Zyrtare.
- Në shkresën e përcjellë nga FTL sh.a. me nr. 320/1 prot., datë 04.02.2021, shoqëria bën me dije se ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për realizimin e ndryshimit/zhvillimit në platformën IT online të blerjes së energjisë, me qëllim përdorimin e saj edhe për procedurat e shitjes. FTL sh.a. ndër të tjera në shkresë parashtron se është lidhur kontrata e shërbimit në datën 11 Janar 2021, me subjektin fitues i cili do të bëjë ndërhyrjet në platformën IT online, si dhe në kontratë është përcaktuar se afati për implementimin e

ndryshimeve/zhvillimeve të platformës është 65 (gjashtëdhjetë e pesë) ditë nga data e lidhjes së kontratës.

- Nga analiza e afateve të raportuara nga vetë shoqëria FTL sh.a në shkresën e sipërcituar, rezulton se hyrja në fuqi e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 202, datë 02.12.2020 nuk mund të shtyhet deri në fund të muajit Prill siç shoqëria ka kërkuar, por deri në 31 Mars 2021.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Shtyrjen e datës së hyrjes në fuqi të “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 202, datë 02.12.2020, deri në 31 Mars 2021.
2. Për periudhën tranzitore, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, FTL sh.a. për qëllim të procedurës së shitjes së tepricave të energjisë elektrike, të përdorë “Rregullat e përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a” të miratuar me vendimin nr. 5233/1, datë 12.06.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.
3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë shoqërinë FTL sh.a., dhe palët e interesit të përfshira në dhënien e opinioneve për draftin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”, Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në fletoren zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI